

VENDIM
Nr.10, datë 17.11.1992

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani,	Zv/kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo,	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Natasha Sheshi,	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Ylvi Myrtja,	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Thimo Kondi,	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese

Me sekretare Drita Filto, më datën 30.10.1992; 6,13 dhe 17.11.1992 shqyrtoi në seancën gjygjësore me dyer të hapura çështjen nr.10 që i përket:

KËRKUESE: NDËRMARRJA E PËRBASHKËT SHQIPTARO-FRANCEZE GROUP ADA, e përfaqësuar nga zoti Marsel Skëndo, drejtor dhe zoti Piro Totozani, këshilltar juridik.

PERSON I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga zoti Gjergj Sauli, kryetar i Byrosë Juridike.

OBJEKTI: Të rivendoset e drejta kushtetuese e shkelur nga zbatimi i një akti normativ që nuk është botuar dhe që nuk ka hyrë në fuqi rregullisht (vendimi i Këshillit të Ministrave nr.288, datë 1.7.1992 "Për sistemin e tregut valutor") e të ndreqen pasojat e ardhura.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relacionin përkatës,

VËREN:

Me kërkesën datë 24.9.1992, Shoqëria e Përbashkët Shqiptaro-Franceze GROUP ADA kundërshton vendimin e Këshillit të Ministrave nr.288, datë 1.7.1992 "Për sistemin e tregut valutor", duke parashtror se hyrja në fuqi e këtij vendimi menjëherë, pa u publikuar (pa marrë dijeni të interesuarit rregullisht për përmbajtjen e tij), bie në kundërshtim me dispozitat kryesore kushtetuese, që parashikojnë se ligjet hyjnë në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas botimit të tyre në "Gazetën Zyrtare", si dhe me normën ligjore që përcakton se "Shqipëria do t'i bëjë të njohura publikisht të gjitha ligjet, rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë ose ndikojnë në investimet e huaja". Për rrjedhojë, pretendon kërkuesi, sekuestrimi prej Policisë Financiare i vlefës prej 42072.83 USD të shitjeve në valutë të huaj të realizuara nga data 1 deri më 31 korrik 1992, kur ende nuk kishin marrë dijeni për miratimin e aktit në fjalë, duhet të konsiderohet veprim i paligjshëm dhe shuma e mësipërme duhet t'u kthehet.

Nga shpjegimet e palës kërkuese, nga shqyrtimi i dokumentave të paraqitura prej saj, nga përgjigjja e dhënë prej përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave, sipas të cilit Vendimi i lartpërmendur nuk rezulton t'u jetë komunikuar të interesuarve as drejtpërdrejt e as nëpërmjet Ministrisë së Tregtisë e të Marrëdhënieve Ekonomike me Jashtë apo prej ndonjë institucioni tjetër, si dhe nga tërësia e provave të shqyrtuara gjatë gjykimit të çështjes rezulton, se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.288, datë 1.7.1992 "Për sistemin e tregut valutor", është bërë i njohur publikisht vetëm pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare nr.5 të vitit 1992, që mban datën e daljes prej shtypit më 25.9.1992.

Përsa i përket kohës së shpalljes dhe të hyrjes në fuqi të akteve juridike normative, ligji nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", parashikon se "ligjet shpallen jo më vonë se 15 ditë pas miratimit dhe hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit të tyre në Gazetën Zyrtare (Fletoren Zyrtare), duke përjashtuar rastet kur parashikohet ndryshe nga vetë ligjet si dhe rastet e ligjeve organike" (neni 23, paragrafi i tretë), ndërsa vendimet, urdhëresat e udhëzimet që nxjerr Këshilli i Ministrave në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe për zbatimin e tyre... "kur kanë karakter normativ,

botohen në Gazetën Zyrtare, me përjashtim të rasteve të veçanta të parashikuara me ligj". (neni 36, pika 2) Gjithashtu, sipas nenit 39, paragrafi i tretë, të ligjit kushtetues, "Ministrat, për çështjet që janë në kompetencën e tyre, nxjerrin urdhëra, rregullore e udhëzime në bazë të ligjeve dhe të urdhëresave e të vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe për zbatimin e tyre. Aktet e ministrave me karakter normativ botohen në Gazetën Zyrtare, me përjashtim të rasteve të veçanta të parashikuara me ligj".

Nga përmbajtja e normave kushtetuese të sipërpërmendura rezulton se rregulli i përgjithshëm është botimi i ligjeve dhe i akteve të tjera normative në Fletoren Zyrtare (Botim i Kryesisë së Kuvendit Popullor). Botimi në Fletoren Zyrtare është mënyra e domosdoshme e publikimit d.m.th., e marrjes dijeni rregullisht prej subjekteve për përmbajtjen e tyre, por ligji kushtetues në fuqi lejon mundësinë e parashikimit, në raste përjashtimore, edhe të ndonjë forme tjetër për publikimin e përmbajtjes së tyre, veçse ky përjashtim mund të bëhet vetëm me ligj.

Pra, në bazë të këtyre normave kushtetuese Kuvendi Popullor, kur e çmon të nevojshme, miraton ligj ku parashikon rastet e veçanta kur lejohet mosbotimi i aktit normativ në Fletoren Zyrtare. Në këto raste ai detyrimisht duhet të përcaktojë format e tjera të përshtatshme të botimit të tyre.

Hyrja në fuqi e ligjeve dhe e akteve të tjera normative kushëzohet prej botimit të tyre, por këto dy momente nuk mund dhe nuk duhet të përputhen. Kurdoherë është e nevojshme të caktohet një afat optimal i marrjes dijeni për përmbajtjen e normave të reja apo të ndryshimeve në ato ekzistueset, sepse askush nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për mosnënshtrimin e sjelljes së tij ndaj një norme ende të panjohur. Ky afat optimal është afati 15 ditor i caktuar nga ligjvënësi, i cili fillon nga data e botimit në Fletoren Zyrtare. Edhe në rastet kur në tekstin e ligjit apo të aktit tjetër normativ parashikohet hyrja në fuqi e aktit menjëherë, siç ndodh shpesh në praktikën e Parlamentit dhe të Këshillit të Ministrave, kjo duhet të nënkuptojë rregullin e përgjithshëm të hyrjes në fuqi 15 ditë pas botimit të aktit. Në rastet kur ligjvënësi çmon se është i domosdoshëm një afat i ndryshëm nga afati 15 ditor i lartpërmendur, atëherë ky afat duhet të përcaktohet prej tij dhe të shprehet në tekstin e vetë ligjit.

Nisur nga arsyetimet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese, arrin në përfundimin se, ndonëse në përmbajtjen e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.288, datë 1.7.1992 "Për sistemin e tregut valutor", nuk vërehet ndonjë pakushtetutshmëri ose paligjshmëri, zbatimi i këtij vendimi pa u publikuar zyrtarisht dhe pa hyrë në fuqi rregullisht përbën shkelje të një të drejte kushtetuese për subjektet që u drejtohet ky vendim. Për rrjedhojë, ndërmarrja e përbashkët GROUP ADA legjitimohet në kërkesën e saj për anulimin e pasojave të kundërligjshme të ardhura nga zbatimi i menjëhershëm i këtij vendimi.

Duke u pranuar si e ligjshme kërkesa e ndërmarrjes së përbashkët ADA, vendimet nr.459/1 dhe 459/2, datë 14.9.1992, të degës së Policisë Financiare Tiranë, të bazuara në pikën 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.288, datë 1.7.1992, mbeten pa bazë ligjore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të pikës 9 dhe 10 paragrafi i dytë dhe i tretë të nenit 24 të ligjit "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

VENDOSI:

Zbatimi i Vendimit nr.288, datë 1.7.1992 të Këshillit të Ministrave "Për sistemin e tregut valutor" pa u botuar dhe pa hyrë në fuqi rregullisht nga Dega e Policisë Financiare Tiranë përbën shkelje të së drejtës kushtetuese të firmës ADA.

Të detyrohet Dega e Policisë Financiare Tiranë të shfuqizojë vendimet e marra në zbatim të pikës 16 të vendimit nr.288, datë 1.7.1992 të Këshillit të Ministrave të dhëna para hyrjes në fuqi rregullisht të këtij vendimi

Vendimi hyn në fuqi në datën e njoftimit të tij.

Tiranë, më 17.11.1992